



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Nr. 1550/110 Prot.

Tiranë, më 13.06. 2023

VENDIM

Nr. 70 dt. 13.06.2023

PËR

**HAPJEN E THIRRJES PËR VETËKANDIDIM PËR ANËTAR TË KOMISIONIT TË  
SIGURIMIT TË CILËSISË DHE KURRIKULAVE**

Në zbatim të nenit 38 pika 1 (gërma i) të nenit 38, nenit 46 pika 3 dhe 6 të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M-së nr 57 datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës”, nenit 20 (gërma nj) si dhe nenit 26 të Statutit të UST-së, nenit 3 të Rregullores së Organizimit të Veprimtarisë së Komisionit Për Kurrikulat, nenit 23 të Rregullores për Organizimin e Zgjedhjeve për Autoritetet dhe Organet Drejtuese në UST, Senati Akademik në mbledhjen e datës 13.06.2023,

V E N D O S I :

1. Hapjen e thirrjes për vetëkandidim për anëtar të Komisionit të Sigurimit të Cilësisë dhe Kurrikulave, me këtë përbërje:
  - 4 (katër) anëtar personel akademik;
  - 1 anëtar përfaqësues i studentëve;
2. Regjistrimi i kandidatëve të kryhet pranë Sekretarisë së Senatit Akademik të UST-së për 7 (shtatë) ditë pune, nga data 14.06.2023 deri në 22.06.2023.
3. Kandidatët e interesuar në momentin e aplikimit duhet të cilësojnë qartë emrin e komisionit ku vetëkandidojnë.

4. Sekretari i Senatit Akademik të përpilojë “Njoftim” për të gjithë të interesuarit me të dhënat e sakta për kriteret, mënyrën, vendin dhe periudhën kohore të aplikimit.
5. Ngarkohen për zbatimin e këtij Vendimi drejtuesit e njësive kryesore si dhe Sekretari i Senatit Akademik.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**

**Prof. Dr. AGRON KASA**

